



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDËS: HYRJE NË HISTORINË E ANTIKITETIT**

**Pedagogu:** Prof. Dr. Iris Pojani  
**Ngarkesa:** 4 ECTS (45 leksione dhe 15 seminare)  
**Lloji i lëndës:** Lëndë me zgjedhje  
**Programi i studimit:** bachelor  
**Viti/Semestri:** I/I

#### **EKSTRAKT**

Hyrja në historinë e antikitetit përpiqet të japë njohuritë bazë për një periudhë komplekse të historisë së njerëzimit, duke nisur nga qytetërimet e ashtuquajtura « egjeane », veçanërisht ai minoik e mikenas, e deri tek lindja dhe zhvillimi i qytetërimit romak, si një nga qytetërimet që ka ndikuar gjerazi në qytetërimin e sotëm evropiano-perëndimor. Nëpërmjet leksioneve gjerësisht të ilustruara dhe diskutimeve në klasë, programi i lëndës synon të përcjellë njohuri të përgjithshme rreth periudhës antike, metodave të kërkimit, periodizimit dhe qytetërimeve. Objektivat e lëndës do të realizohen nëpërmjet mësimdhënies formale në klasë, diskutimit në seminare, por edhe nëpërmjet disa vrojtimeve praktike dhe vizitave në muzetë historikë e arkeologjikë. Studentët do të pajisen me njohuri rreth kulturës materiale, modeleve ekonomike dhe zhvillimeve sociale dhe politike, besimit, etj.

#### **TEMAT:**

**LEKSION 1.** Hyrje. Ç'është historia e Antikitetit dhe cili është objekti i studimit të saj. Periodizimi : linjat e përgjithshme; burimet e shkruara historike.

**LEKSION 2.** Veçoritë e përgjithshme të zhvillimit të qytetërimeve të hershme dhe ato të « ashtuquajtura » egjeane ; Kreta dhe Mikena

**LEKSION 3.** “Kolonizimi” dhe disa çështje që lidhen me të. Valët kryesore kolonizuese dhe problemet social-politike dhe ekonomike që u paraprinë këtyre lëvizjeve.

**LEKSION 4.** Luftrat Medike dhe luftrat e Peloponezit. Kushtet gjeo-politike ne të cilat u zhvilluan dhe rrjedhojat e tyre.

**LEKSION 5.** Mitologjia greke: perënditë kryesore dhe sferat e funksionimit të tyre.

**LEKSION 6.** Arti dhe arkitektura greke. Tempujt e gurit dhe tipologjitë kryesore, orderat.

**LEKSION 7.** Artizanati grek nga konceptet tek funksionimi i tij. Punishtet kryesore të prodhimit dhe modalitetet e funksionimit të tyre.

**LEKSION 8.** Roma dhe Italia ne kohën e luftrave punike

**LEKSION 9.** Aspekte shoqërore dhe institucionet në periudhën republikane

**LEKSION 10.** Luftrat civile dhe triumfi i Cezarit.

**LEKSION 11.** Evolucioni politike i Perandorisë Romake (27 para Kr-235 pas Kr)

**LEKSION 12.** Perandoria Romake – hapsirë e organizuar dhe e administruar. Ushtria romake.

**LEKSION 13.** Kriza Perandorisë Romake (235-284)

**LEKSION 14.** Vizitë në Muzeun Arkeologjik/Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë.

**LEKSION 15.** Qytetërimi ilir në udhëkryqet e kulturave mesdhetare

## **FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**

### **FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

*15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

### **KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

*25 % e notës përfundimtare.*

### **DETYRA E KURSIT:**

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3- 5 faqe format A4, Times Nëë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

*20 % e notës përfundimtare*

### **KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*40 % e notës përfundimtare*

**LITERATURA:**

1. P. CABANES, *Historia e Adriatikut: Adriatiku në kohën e lashtë*, Tiranë, 2006 (veçanërisht **Kreu I** “Koha e ekspeditave legjendare” dhe **Kreu II** “Kolonizimi grek dhe marrëdhëniet me popullsitë e vendosura në të dyja brigjet e Adriatikut”, f. 29-39, f. 45-62)
2. P. CABANES, *Hyrje në historinë e Antikitetit*, Paris, 2004
3. N. CEKA, M. KORKUTI 1998 *Arkeologjia*. Shtëpia Botuese “Libri Universitar”, (shblu), Tiranë.
4. I. FINLEY (edt.) *Atlas of classical Archaeology*, London, 1977
5. R. HINGLEY, *Globalizing Roman Culture: Unity, diversity and empire*, London, 2005
6. C. MOSEE A. SCHNAPP: *Précis d’histoire grecque*, Armand Colin, Paris 2014
7. J-P. MARTIN. A. CHAUVOT: *Histoire romaine*, Armand Colin, Paris 2010